

Kuadri historik i linguistikës shqiptare



Nga PHD. Vëllor Friedmann, profesor në Universitetin e Çikagos-SHBA.

Duke qënë se është e vështirë të paraqesësh një tablo të plotë të historisë së linguistikës shqiptare në një referat të shkurtër, po ndalem vetëm në studimin e shqiptarëve në U.S.A. si subjekt akademik dhe objekt i arsimit të lartë. Në artikull kam ndërmend të adresoj jo vetëm faktet e linguistikës shqiptare në Amerikë, por edhe ndërlidhjet e natyrës së një shoqërie demokratike. Gjithësesi, më duhet të filloj me analizën ose analizat, pasi e imja nuk është orvatja e parë për përshkrimin e linguistikës albanologjike në U.S.A..

Ndoshta orvatja e parë e vlerësimit të gjendjes së fushës në fjalë, në U.S.A., u përgatit më 1969 nga sllavi Eduard Stankiewicz me analizën e titulluar "Gjuha dhe zona e studimeve: Evropa Qendrore, Lindore dhe Juglindore", redaktuar nga Charles Jelavich. Në kohën që po shkruante, Stankiewicz u lidh vetëm me dy linguistë amerikanë, Eric Hamp dhe Leonard Newmark, duke shfaqur atë çka ai e quante "më tepër se një interes kalimtar" në linguistikën shqiptare. Ai përmend Gordon Messing, një specialist për gjuhën greke, që ka bërë botime edhe në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit. Në këtë kohë Universiteti i Çikagos ishte i vetmi institucion i studimeve të larta, ku shqiptarëve u jepej mësim, megjithëse, me sa do të shohim shkurtimisht më poshtë, shqiptarëve u është dhënë mësim edhe në universitet të tjera, në kohë të ndryshme.

Një përshkrim i linguistikës shqiptare në përgjithësi u përgatit në vitin 1969 e u botua më 1972 nga një prej albanologëve më të shquar amerikanë, Eric Hamp, në vëllimin e nëntë të sërës "Prijet e tanishme në linguistikë". Artikulli për-

ban të dhëna bibliografike të vlefshme për Hamp dhe për Newmark. Gjithashtu, përmend edhe punime që kanë lidhje me gjuhën shqipe, duke përfshirë këtu edhe studimin e Lowman (botuar më 1932). mbi fonetikën shqiptare. Ajo është bazuar në dialektin shkodoran, të botuar në gazetën më të rëndësishme në fushën e linguistikës në U.S.A., "Gjuha". Përveç

Lowman edhe britaniku Stuart Mann ka botuar nga fundi i Luftës II Botërore një artikull në shqip në gazetën "Gjuha", studim ky për sonorantet indo-evropiane, sikurse dhe dy të tjerë më 1952 dhe më 1957 për zanoret dhe bashkëtingëlloret.

Vetëm pas Luftës së II Botërore studimi i shqipes në U.S.A. u pasqyrua në disertacione doktoraturash e në një numër botimesh. Në analizën e tij të vitit 1972. Hamp u bazua në shënimet e shkurtra mbi fshatrat arbëreshe në Itali, të cilat janë marrë nga "Historia e alfabetit shqip" të George N. Nasse (1964) dhe Stavro Shtëndi (1960). Në artikullin e tij Hamp kishte si bashkautor studentin e tij Dimitros Moutsos. Artikulli titullohej "Toponimet Arvanite". Ato çka thamë më lart nxjerrin në pah se studimi i shqipes, përveç rëndësisë për linguistikën indo-evropiane dhe vlerave të brendëshme për studimin e topologjisë linguistike është edhe në qendër të asaj dege lidhëse të linguistikës, që i përket gjuhëve ballkanike.

Pas analizës së Hamp kemi një boshllëk prej 25 vjetësh, të pasuar me 3 analiza, 2 të Peter Pritit (1997 dhe 1998) dhe 1 të Xheladin Gosturanit (1999). Analiza e Pritit, e titulluar "Mësimi i Gjuhës Shqipe në Sh.B.A." përbëhet nga 2 pjesë dhe është një përshkrim mbi studimet e shqiptarëve në Sh.B.A.. Ajo është publikuar në revistën shqiptare "Gjuha Jonë". Pjesa e parë përqendrohet në mësimin e shqipes në komunitetet shqiptare në Amerikë, megjithëse mësimi i gjuhës në diasporën shqiptare në Amerikë është jashtë kompetencave të këtij referati, përderisa të tilla aktivitete nuk i përkasin arsimit të lartë, çështjet e përdorimit të gjuhës dhe mirëmbajtjen e saj janë çështje me interes.

Pjesa e dytë e artikullit të Pritit analizon shumicën e programit të gjuhës shqipe në U.S.A. dhe jep një bibliografi të librave mësimore, studimeve monografike, duke përfshirë edhe dizerta-

cionet doktorale. Puna e Gosturanit është një historik i albanologjisë prej rreth 300 faqesh. Gosturani citon në veprën e tij punimet e lartpërmendura të Lowman dhe të Mann si dhe të Hamp, Newman, Gary Bevington, Janet Byron, Philip Hubbard, Martin Huld, Gaspar Kichi, si dhe autorin e këtij artikulli, etj.

Nga ata që përmend Gosturani, Hamp, Hubbard, Byron, Newmark dhe Huld kanë shkruar disertacione doktorature për shqiptarët. Në këtë listë mund të shtohet edhe Roger W. Wescott, Bardhyl Pogoni dhe Victoria Massey, të cilët e çuan numrin e përgjithshëm të disertacioneve për doktoraturë mbi linguistikën shqiptare në nëntë (1948-1991).

Megjithëse numri i disertacioneve amerikane, për gjuhën shqipe është i vogël, po të jashtë këtu një numër disertacionesh, që përdorin të dhëna shqiptare, përfshirë këtu edhe mua, të cilët edhe pse i qëndrojnë besnikë kategorive gramatikore të mënyrës dëftore të gjuhës maqedonase, si dhe mënyrës habitore të shqipes, është prapëprapë rasti të themi se numri i disertacioneve amerikane mbi Shqipërinë shtrihen në një kufi tepër të gjerë të çështjeve linguistike. Studimi i Hampit është mbi një dialekt arbëresh. I Newmark është një përshkrim strukturor i Beratit. Wescott dhe Bevington përshkruajnë fonologjinë shqiptare, duke përdorur koriza teorike të kohëve të tyre dhe repektivisht më 1948 dhe 1974, ndërsa Massey dhe Hubbard përdorin që të dy të dhëna shqiptare për të përpunuar teorinë sintaksore. Studimi i Huld është një studim i pastër etimologjik, ndërsa i Pogonit dhe Byronit përqendrohen në çështjet e standardizimit të gjuhës.

Le të kthehemi shkurtimisht te mësimdhënia e shqipes në U.S.A., pas të cilës do të jap disa observime për ndikimin e faktorëve gjeo-politikë mbi studimin e shqipes në U.S.A., të shoqëruar me komente të gjendjes së tanishme të arit dhe vështirësive në të ardhmen për ndërtimin e demokracisë.

Ekspërjencia ime në mësimdhënie e shqipes në pranverën e vitit 1998, është gjithashtu, një rast në fjalë. Për shkak të rrethanave të krijuara, unë kisha 14 student të regjistruar në kurs. Në kuatrimestrin e më parshëm dhashë mësim në një kurs të quajtur "Fuqija dhe Identiteti i Gjuhës në Evropën Juglindore". Një vëzhtrim linguistik amerikan i krizave të Ballkanit (është një koment i trishtueshëm, me të cilin i kam dhënë mësim një kursi me këtë titull në 1995, përpara se të nënshkruhej marrëveshja e Dej-

tonit, por gjithësesi nuk ka ndonjë tregues që të më shpjegë për të revizionuar titullin në çdo kohë në një të ardhme të parashikueshme). Shtatë të padiplomuave u ngjall kureshtja nga ato që kishin dëgjuar rreth kursit intensiv 10-javor të orientuar drejt dimitës së lexuar në një nga gjuhët për të cilat kishin njohuri dhe ishte tepër tërheqëse për ta për t'u regjistruar. Tre studentë të diplomuar me interesin për linguistikën Ballkanike, një i interesuar në atë Indo-Evropiane dhe dy të tjerë të padiplomuar, që ishin thjesht kuriozë rreth gjuhëve, një nga të cilët kishte studiuar Rumaninë sëbashku me mua e çuan numrin e përgjithshëm në 14.

Kursit iu dha mësim, duke përdorur librin e Zymberit (1991) për ushtrime dhe për pjesë leximi, të kombinuar me një praqitje të përmbledhur gramatikore timen (të pa publikuar). Ushtrimet ishin zgjedhur të atilla që të forconin përvetësimin pasiv të njohjes, që është çelësi i drejtitimit të aftësisë për të lexuar. Për këtë lloj drejtimi, është më mirë përdorimi i librave mësimore. Kështu, për shembull, libri i Lewis (1953) është më i miri për turqisht, ndërsa për shqipin ai i Zymberit (1991) bën shumë punë. Nga librat e tjerë të gjuhës shqipe në anglisht, ai i Newmark i, 1980, që është, gjithashtu, audio-viziv, megjithëse i orientuar nga drejtimi bashkëbisedues, është një zgjedhje e mirë. Gjithashtu librat e Camajt (1984), Ndrizarit (1947), Pipës, të tëra në dialektin Gegë e Toskë, sëbashku janë një zgjedhje e mirë. Libri i Camajt (1984) mund të përdoret me efikasitet në vitin e dytë në kursin e gjuhës shqipe. Për kritikën e librit të Drizarit, shih Newmark. Metoda e Zymberit ka 24 mësim. Në një hark kohor 10-javor, me 3 orë në javë, programi përbante një mësim për çdo orë mësimore, me një detyrë kontrolli mbi gramatikën në çdo tre mësim, me theksim të leximit me zë të lartë dhe përkthimi. Orët e fundit u shpenzuan në leximin e pjesëve të ndryshme që përbëjnë një veçori të shkëlqyeshme në fund të leksioneve të librit të Zymberit (1991).

Shënim:

Autori e mbajti këtë referat në simposiumin: "Arsimi i lartë - Rruga drejt demokracisë dhe stabilitetit" - Organizuar në Tiranë nga Ministria Arsimit dhe Shkencës, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane